

CRNA GORA  
Opština Tuzi  
Br.Nr: 01-031/20- 4568  
Tuzi- Tuzi, 26.05.2020. godine

MALI I ZI  
Komuna e Tuzit

**SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI**  
**n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku**

**PREDMET:** Dostava Predloga Odluka

**NAPOMENA:** Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine

**PODNOŠILAC PREDMETA:** Predsjednik Opštine

**OBRAĐIVAČ AKTA:** Sekretarijat za planiranje, uređenje prostora i komunalne poslove

**PRILOG:** Predlozi Odluka sa obrazloženjem

Poštovani,

Na osnovu člana 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi („Službeni list CG-opštinski propisi“ br. 24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Predlog Odluke o postavljanju, građenju i uklanjanju privremenih objekata montažnog karaktera na teritoriji opštine Tuzi i
- Predlog Odluke o donošenju Plana privremenih objekata na tratoriji opštine Tuzi.

Za predstavnika predлагаča koji će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Ljeka Ivezaj v.d. sekretara Sekretarijata za planiranje, uređenje prostora i komunalne poslove.

**KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT**  
**Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar**

**LËNDA:** Dorëzimi i Propozim Vendimeve

**VËREJTJE:** Të përfshihen në rendin e ditës në seancën e trallës së Kuvendit të Komunës

**PARASHTUESI I PROPOZIMIT:** Kryetari i Komunës

**PËRPUNUESI I AKTIT:** Sekretariati për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale

**SHTOJÇË:** Propozimi i vendimeve me arsyetime

Inderuar,

Në bazë të nenit 60 paragrafit 2 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Propozim Vendimin për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e komunës së Tuzit dhe
- Propozim Vendimin për miratimin e Planit të objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Tuzit.

Për përfaqësuesit të propozuesit i cili do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Leka Ivezaj, u.d. së sekretarit të Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale.

S poštovanjem,  
Me respekt,

**PREDSJEDNIK -KRYETARI,**

Nik Gjeloshaj



Në bazë të nenit 115, 116 dhe 117 të Ligjit për rregullimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve (“Fl. Zyrtare e Malit të Zi”, nr 64/17, 44/18, 63/18 dhe 11/19), dhe nenit 53 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fl. Zyrtare MZ – dispozitat komunale “ nr. 24/19), Kuvendi i Komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_, 2020 ka sjellë:

## VENDIM

**për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e Komunës së Tuzit.**

### I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen tipat e objekteve të përkohshme të karakterit montues (në tekstin e mëtejmë: objekti i përkohshëm), përcaktohen kushtet dhe procedura për vendosjen dhe ndërtimin e tyre në truallin e pronës shtetërore me të cilin disponon Komuna e Tuzit dhe truallit privat në pronësi private në vendet e banuara në territorin e Komunës së Tuzit.

#### Neni 2

Shprehjet të cilat shfrytëzohen në këtë vendim për personat fizik të gjinisë mashkullore, nënkuptohen edhe për personat fizik të gjinisë femërore.

#### Neni 3

Vendosja dhe ndërtimi i objekteve të përkohshme nënkupton realizimin e punëve në montim, ngritje ose ndërtim të objekteve të përkohshme, si dhe realizimin e punëve në bazamente dhe bashkëngjiten e të njëjtave në objektet e infrastrukturës komunale.

#### Neni 4

Objektet e përkohshme mund të vendosen dhe ndërtohen, me kusht që: nuk e prishin funksionimet ekzistuese komunale dhe të qytetit, nuk pengojnë qarkullimin e këmbësorëve dhe makinave, gjegjësisht sigurojnë kalimin për këmbësorët në hapësirë prej më së paku 2m, nuk e devastojnë natyrën dhe hapësirat e gjelbra publike si dhe nuk e dëmtojnë mjedisin jetësor (zhurmë e tepruar, gazra të dëmshme, ndotje, grumbullim i mbeturinave të rrezikshme dhe të ngjashme).

### II TIPET E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME TË KARAKTERIT MONTUES

#### Neni 5

Objekte montuese të karakterit të përkohshëm sipas këtij vendimi nënkuptohen:

1. objektet montuese të tipit kioskë (në tekstin e mëtejmë: kioskë),
2. kopsht i myllur si objekt i përkohshëm i pavarur,
3. objekt i vogël sportiv,
4. bar i hapur me tarracë,
5. objekt i përkohshëm për nevojat komunale infrastrukturore (ujësjellësit dhe kanalizimit, mbledhjes dhe grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave komunale, telekomunikacionit, sistemet

elektrike dhe të transmetimit dhe të ngashme) dhe objekti i përkohshëm për kryerjen e veprimitarive afariste (kontrolli teknik i automjeteve, auto-larje, treg makinash dhe të ngashme),

6. kopsht i mbyllur në kuadër të objektit hotelier,
7. parking i objektit,
8. pano shpallëse-reklamuese,
9. tendë dhe

10. objekte të cilat mund të zhvendosen nga një vend në tjetrin si: kopsht veror, vitrinë e lirë në këmbë; raft i ekspozuar; kabinë telefonike publike; kioskë në kuadër të stacionit të autobusëve; tezgë lëvizëse; automat për shitjen e cigareve; aparat për shitjen e pijeve freskuese, akulloreve, émbëlsirave, gështenjave, kikirikë dhe të ngashme; kazan për misër; pult për ekspozimin dhe shitjen e librave, gazetave, publikimeve të tjera dhe cd; automjet i veçantë që ka atest prodhues për kryerjen e veprimitarisë; objekte për performimin e programeve argëtuese (luna parku, akua parku etj); pult për ekspozimin dhe shitjen e sendeve dekoruese, luleve dhe fotografive; objekte për ofrimin e shërbimeve të thjeshta ambulante hoteljerike; lokale mbi ujë; rrugët e kartingut; brenta, gater dhe cirkular si dhe pajisje të ngashme të cilët sipas dispozitave të këtij vendimi kanë karakter të objektit të përkohshëm.

#### **Neni 6**

Kiosku është objekt i tipit të përkohshëm lëvizës, i prodhuar nga prodhuesi i autorizuar, prej materialeve të kualitetit të lehtë i cili montohet në bazamentin përkatës (beton, soletë guri etj.) në hapësirën e paraparë me Planin për vendosjen e objekteve të përkohshme (në tekstin e mëtejmë: Plani).

#### **Neni 7**

Kopshti i mbyllur si objekt i përkohshëm i pavarur është objekt i konstruksionit të lehtë, prej përbërësve montues, me mure të tejdukshme dhe me kulm të mbuluar, i cili montohet në bazamentin përkatës (beton, soletë guri etj.) në funksionin e veprimitarisë hoteliere dhe veprimitarive të tjera, në hapësirën e paraparë me Plan.

#### **Neni 8**

Objekti i vogël sportiv është objekt me përbërje adekuate dhe me pajisje të instaluara, të tipit të mbyllur (sallë - balonë) që është i punuar prej përbërësve montues me mure dhe kulm të mbuluar me pelhurë të plastifikuar ose impregnuar, ose materialit tjetër të ngashëm i cili vendoset si objekt i pavarur në funksion të aktiviteteve sportive ose të tipit të hapur, i cili vendoset në hapësirat e parapara sipas Planit, në shërbim të aktiviteteve sportivo-rekreative ( futboll, basketball, volejboll, hendboll, tenis, rrëshqitje, notim, mini-golf e të ngashme).

Bashkë me objektin e vogël sportiv nga paragrafi 1 i këtij neni mund të vendosen përbërësit përcjellës (bar, kafe, zhveshtore, kabinat e dusheve etj.).

#### **Neni 9**

Banak i hapur me tarracë është objekt i tipit që vendoset në bazamentin e gatshëm ekzistues për kryerjen e pavarur të veprimitarisë së hotelerisë.

#### **Neni 10**

Objekti i përkohshëm i cili vendoset dhe ndërtohet për nevojat e infrastrukturës komunale, telekomunikacionit, sistemit elektrik dhe informativ është objekt tipik i destinuar përkohshëm i cili vendoset në konstruksion me themelë si objekt i stacionuar (oborr për riciklim, shtyllë antene, stacion qendror me pajisjet përcjellëse dhe objekte tjera të ngashme).

Objekti i përkohshëm për kryerjen e veprimtarive afariste është tip i objektit të karakterit montues-demontues, punuar prej elementeve të industrisë metalike apo elementeve të tjera të konstruksionit (kontrollit teknik i automobilave, autolarjeve etj.).

Tregu i veturave është truall i pajisur përkohësisht i cili shfrytëzohet për treg të veturave.

### Neni 11

Kopshti i mbyllur në kuadër të objektit hotelier është objekt i konstruksionit të lehtë, prej elementeve montuese, me mure të tejdukshme, mbulojë të kulmit (beton, soletë guri dhe ngashëm) bashkë me objektin hotelier në funksion të tij, në hapësirën e paraparë me Plan.

### Neni 12

Kushtet dhe procedura për vendosje, ndërtim dhe largim të objekteve të parkimit në territorin e Komunës së Tuzit, përcaktohen me dispozita të veçanta të Komunës së Tuzit.

### Neni 13

Panoja e shpalljeve është objekt në të cilin shoqëria afariste, person tjetër juridik dhe afarist, vë në pah posterat, lajmërimet, lajmëron, shpall dhe ngashëm, me qëllim të informimit dhe lajmërimit përmajtjen e manifestimeve argëtuese, kulturore dhe sportive, për kryerjen e aktiviteteve dhe ngashëm, si dhe lajmërimet e vdekjeve si dhe shpallje dhe lajmërimë të ngashme.

Pano reklamuese konsiderohen:

- objektet në të cilat shoqëritë afariste, persona të tjerë juridik dhe afaristë reklamojnë,
- objektet e shoqërive afariste, persona të tjerë juridik dhe afaristët e regjistruar për kryerjen e veprimtarive reklamuese, përkatesisht marketingut, të cilët për qëllime komerciale reklamojnë veprimtarinë, prodhimet dhe shërbimet ndaj personave të tretë (pano reklamuese të tipit: megabord, bigbord, billbord, metrolajt, stililajt dhe ngashëm),
- panot e reklamimit të cilët vendosen nëpër fasada dhe çatitë e ndërtesave (muralet, panot, reklamat e shkruara, reklamat me ndriçim, displejet, reklamat me shkëmbim elektronik të reklamave reklamuese, bekllajtet, totemet e ndriçuara, reklamat elektronike roto-trision, reklama elektronike vrapuese dhe të ngashme), në të cilat shoqëritë afariste, personat e tjerë juridik dhe afaristët reklamojnë veprimtaritë për nevojat e veta ose në të cilat shoqëritë afariste, personat e tjerë juridik dhe afaristët e regjistruar për kryerjen e veprimtarive reklamuese, përkatesisht marketingut, për qëllime komerciale, reklamojnë veprimtarinë, prodhimet dhe shërbimet ndaj personave të tretë ose ofrojnë shërbime informative,
- panoja reklamuese e cila vendoset në shtyllën e ndriçimit publik,
- transparentet reklamuese, flamujt reklamues dhe ngashëm.

Vendosja e panove reklamuese nga paragrafi 2 alineja 4 e këtij nenit, i miratohet shërbimit publik të cilit i janë besuar punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, për qëllime të reklamimit të veprimtarive, prodhimeve dhe shërbimeve të personave të tjerë juridik dhe afaristëve.

### Neni 14

Tenda është konstruksion i cili vendoset në fasadën e ndërtesës ose kioskave mbi hyrje dhe dritaret e dyqaneve ose konstruksionit të stacionuar për mbulimin e kopshteve verore, me shtyllat e veta, e mbuluar me pëlhurë të plastifikuar ose të impregnuar dhe me material tjetër të ngashëm, i cili vendoset në konstruksionin e lehtë metalik dhe nuk mund të mbyllët.

### Neni 15

Objekte të karakterit të përkohshëm të cilët mund të zhvendosen nga një vend në vendin tjetër cilësohen:

- kopshti veror është hapësirë para objektit të hotelerisë me mobilet përkatëse (tavolina, karrige etj) i pambuluar ose i mbuluar me çadra diellit, me tendë industriale të palosshme ose me konstruksion të lehtë të punuar nga metali ose përbërës të tjerë montues me mbulim të kulmit të punuar prej materialit të lehtë, e rrethuar me urnament dekorativ lëvizës, lulishteve e të ngjashme, në të cilën ofrohen shërbime të hotelerisë dhe është në funksion të objektit të hotelerisë,
- kabina telefonike është objekt i dedikuar i tipit montues,
- parku argëtues është bashkësi e elementeve konstruktive, pajisjeve, aparateve dhe pajisjeve të tjera, të cilët montohen dhe vendosen në truallin ndërtimor për realizimin e programeve argëtuese (luna parku, akua parku, e të ngjashme.),
- tezga është objekt i tipit të përkokshëm, i ndërtuar prej materialeve kualitative të lehta i cili vendoset në truallin ndërtimor, me qëllim të kryerjes së veprimitarise,
- rafti i ekspozimeve është objekt i tipit, i ndërtuar prej materialeve kualitative të lehta i cili vendoset në truallin ndërtimor, dhe në funksion të kryerjes së veprimitarive që kryhen në objekt;
- aparati për shitjen e pijeve freskuese, akulloreveëmbëlsirave, gështenjave, kikirikit e të ngjashme, është objekt i përkokshëm i cili vendoset në truallin ndërtimor ose para objektit, me qëllim të kryerjes së veprimitarise ose para objektit me qellim të kryerjes së veprimitarise e cila bëhet në objekt.

### **III PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOSSHME**

#### **Neni 16**

Objektet e përkokshme nga neni 4 i këtij vendimi vendosen në lokacione të cilat janë të parapara në Planin për vendosjen e objekteve të përkokshme.

Plani sjellët për territorin e Komunës së Tuzit.

Plani mund të sjellët me fazë, për zona të veçanta të Komunës së Tuzit dhe sipas llojeve të objekteve të përkokshme.

Plani përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

Pjesa tekstuale përmban dispozitat e përgjithshme dhe kushtet urbanistike dhe teknike të vendosjes së objekteve të përkokshme në pikëpamje të llojit, tipit, sipërfaqes dhe pamjes së objekteve të përkokshme dhe afatin në të cilin miratohen.

Pjesa grafike e planit përmban lokacionet për vendosjen e objekteve të përkokshme në truallin në pronësi të shtetit me të cilin administron komuna, përvç me objektet e parkimin, panove reklamuese-shpallëse, temave dhe objekteve të cilat mund të zhvendosen nga njëri vend në tjetrin.

#### **Neni 17**

Vendimin për pjesëmarrjen në hartimin e Planit e sjellë kryetari i Komunës së Tuzit.

Planin e harton organi i administratës së Komunës së Tuzit kompetent për punë kommunale (në tekstin e mëtejmë: Organi i administratës kompetent për punë komunale), në bashkëpunim me organin e administratës së Komunës së Tuzit kompetent për punët e planifikimit dhe rregullimit hapësinorë (në tekstin e mëtejmë: organi i administratës kompetent për punët e planifikimit dhe rregullimit hapësinorë).

Hartimi i Planit mund ti besohet edhe shoqërisë afariste të autorizuar ose personit tjetër juridik, në proces dhe në mënyrë të paraparë me dispozitat e Ligjit mbi prokurimet publike, në bazë të detyrës projektuese të cilin e përcakton organi i administratës kompetent për punët komunale.

Kryetari i Komunës së Tuzit themelon Komisionin për vlerësimin profesional të Planit i cili e harton reportin.

Planin e sjellë Kuvendi i Komunës së Tuzit në periudhë prej 5 vitesh.

Ndryshimet dhe plotësimet e planit kryhen sipas procedurës për sjelljen e tij.

Plani publikohet në web-faqen e Komunës së Tuzit.

#### **IV KUSHTET DHE PROCEDURA PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME**

##### **Neni 18**

Objektet e përkohshme vendosen dhe ndërtohen në bazë të lejeve të lëshuara për vendosje dhe ndërtim (në tekstin e mëtejmi: leje).

Lejet i lëshon organi i administratës kompetent për punët komunale.

Leja lëshohet në formën e aktvendimit dhe përmban dhe përmban të dhënat për: shfrytëzuesit, lokacionit, sipërfaqes që shfrytëzohet, llojit dhe qëllimit të objektit, sipërfaqes së objektit të përkohshëm, kohës së shfrytëzimit, detyrimit të shfrytëzuesit në pikëpamje të rregullimit të hapësirës dhe ndërlidhjes në infrastrukturën komunale.

##### **Neni 19**

Bashkë me kërkesën për dhënien e lejes nga neni 18 bashkëngjitet:

- 1) dëshmi mbi të drejtën në pronësi, gjegjësisht të drejte tjetër në truall, për objekte nga neni 5 paragrafi 1 pika 1,2,3,4, 5 dhe 7;
- 2) aktvendimin ideor për objektet nga neni 5 paragrafi 1 pika 1,2,3,4,5, 6 dhe 7;
- 3) Projekti kryesor i rividuar për objektet e përmendura në nenin 5 paragrafi 1, pika 3 (nëse objekti sportiv përmban lehtësira përcjellëse), 6 (nëse tarracë hotelieri është mbi 30 m<sup>2</sup> sipërfaqe bruto) 5 (nëse objekti është mbi 30 m<sup>2</sup>) dhe 7 (për parkingje sipër 200 hapësira parkimi)
- 4) Certifikatën e prodhuesit për objektet e përmendura në nenin 5 paragrafi 1, pikat 3, 4 dhe 8;
- 5) dëshmi mbi qiranë e truallit në pronësi të shtetit ose komunës për objektet nga neni 4 paragrafi 1 pika 1, 2, 3, 4 dhe 5 dhe kompenzimit të paguar për transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale për vendosjen e objektit të përkohshëm;
- 6) shfaqja grafike për objektet nga neni 5 paragrafi 1 pika 8, 9 dhe 10;
- 7) dëshmi për taksen e paguar komunale për objektet nga neni 5 paragrafi 1 pika 6, 8 i 10;
- 8) vërtetim nga institucioni kompetent se me vendosjen e panos reklamuese në fasadë apo mbi çati, nuk rrezikohet stabiliteti i ndërtësës dhe fletëpajtimin nga ana e pronarit, përkatësisht kuvendit të bashkësisë së pronarëve për objektet nga neni 5 paragrafi 1 pika 8 që vendosen mbi çati ose nëpër fasadat e ndërtësave;
- 9) dëshmi për pagesën e taksës administrative;
- 10) për objektet e përkohshme të tipit të kopshtit të mbyllur në përbërje të objektit hotelier, tenda pano shpallëse-reklamuese, transparent reklamues dhe flamuri reklamues dhe objektet e përkohshëm të cilët mund të zhvendosën nga njëri vend në tjetrin e të cilët janë në funksion të veprimtarisë së lejuar, leje për kryerjen e asaj veprimtari.

Faktet nga paragrafi 1 pika 3 dhe 5 të këtij neni i realizon organi kompetent për dhënien e lejeve për vendosjen e objektit të përkohshëm, sipas detyrës zyrtare.

Për lëshimin e fakteve nga paragrafi 1 pika 3 dhe 5 të këtij neni nuk paguhet taksë, shtesë, gjegjësisht shpenzime të tjerë për lëshimin e këtij fakti.

### **Neni 20**

Leja lëshohet në afat prej 15 ditësh prej ditës së dorëzimit të kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet e parapara me këtë Vendim dhe Plan.

Leja skadon nëse vodosja ose ndërtimi i objektit të përkohshëm nuk fillon ose nuk përfundon në afat prej 90 ditësh prej nga dita e lëshimit të lejes.

### **Neni 21**

Në parcelat të cilat nuk janë destinuar për këtë qellim në pajtim me planet e vlefshme urbanistike, ndërsa janë pronë e personave juridik ose fizik, mund të vendosen objekte nga neni 5, paragrafi 1 i këtij Vendimi.

Në parcelat të cilat janë dedikuar destinimit në pajtim me planet e vlefshme urbanistike, e që janë në pronësi të personave juridik dhe fizik, mund të vendosen objektet nga neni 5, paragrafi 1 pika 1,4,6,8,9 dhe 10-të e këtij Vendimi.

Në procesin e lëshimit të lejes për vendosjen e objekteve të përkohshme nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, organi i administratës kompetent për punët komunale, gjegjësisht qeverisja lokale e Komunës së Tuzit për objektet në trevën e saj, përcakton kushtet të cilat i dedikohen pozitës, sipërfaqes dhe numrit të objekteve të përkohshme.

Leja nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk mund të lëshohet për vendosjen e objekteve të përkohshëm nga neni 5 pika 1 dhe 5 në parcelat të cilat janë në pronësi të personave juridik dhe fizik në zonat I dhe II të truallit ndërtimor, të cilat janë të përcaktuara sipas dispozitave të veçanta të Komunës së Tuzit.

Përashtimisht rregullores paragrafit 4 të këtij neni, leja për vendosjen e objekteve të përkohshme për nevojat e infrastrukturës komunale mund të lëshohet në parcelat në pronësi të personave juridik dhe fizik në zonat I dhe II të zonës së truallit ndërtimor, të cilat janë përcaktuar me vendim të posaçëm të Komunës së Tuzit me të cilën rregullohet kompenzimi për pajisjet komunale të truallit ndërtimor.

### **Neni 22**

Leja për vendosjen dhe ndërtimin e objekteve të përkohshme lëshohet me afat deri në një vit, gjegjësisht deri në kthimin e truallit destinimit të planifikuar, të përcaktuar me dokument planor, nëse ai afat përcaktohet në afat të shkurtuar.

Përashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, vendimi për vendosjen dhe ndërtimin e objekteve të përkohshme nga neni 5 pika 1,2,3 dhe 5 i këtij vendimi, lëshohet me afat prej 3 vjetësh, gjegjësisht deri në kthimin e truallit destinimit të planifikuar, të përcaktuar me dokument planor, nëse ai afat përcaktohet në afat të shkurtuar.

Leja për vendosjen e objektit të përkohshëm mund të zgjatet, pas skadimit të afatit nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, nëse pronari i objektit më së largu 10 ditë para skadencës, organiz kompetent i dorëzon kërkesën për dhënien e lejes, në formë dhe pajtim me kushtet e parapara me këtë Vendim dhe Plan.

### **Neni 23**

Pronari i objektit të përkohshëm është i obliguar për largimin e objektit të përkohshëm në afat prej shtatë ditësh prej ditës së skadimit të afatit të lejes, gjegjësisht prej ditës së dorëzimit të lajmërimit mbi kthimin e truallit në destinimin e planifikuar të përcaktuar me dokument planor, pa të drejtë kompensimi të vlerës së objektit dhe pa obligime të Komunës së Tuzit për sigurimin e lokacionit tjetër.

Nëse pronari i objektit nuk vepron në pajtim me paragrin 1 të këtij neni, largimi i objektit të përkohshëm do të bëhet në formë të urdhëruar në shpenzim të pronarit të objektit.

Inspektori komunal dhe shërbimi kompetent për realizimin e prokurimit administrativ gjatë ekzekutimit të largimit të urdhëruar të objektit të përkohshëm nuk mbanë përgjegjësi për dëmtimet e objektit ose gjëra e materialit që në to gjendet.

#### **Neni 24**

Në zonat I dhe II të tokës ndërtimore, të përcaktuara me rregullore të posaçme të Komunës së Tuzit, nuk mund të instalohen lehtësira të përkohshme të tipit - automjete speciale që kanë një certifikatë të një prodhuesi për kryerjen e veprimtarive.

#### **Neni 25**

Objektet e përkohshme të tipit- shtand mund të vendosen në zonat I dhe II, vetëm për arsyet e prezantimit dhe promovimit të programit të karakterit edukativ dhe argëtues, lendeve artistike, librave CD-ve, shtypit dhe publikimeve të tjera, fletë urime, lule dhe punëve vendore.

Objektet e përkohshme nga paragrafi 1 i këtij nenit mund të gjenden në lokacionet e lejuara në afatin e paraparë të punës, varësisht prej llojit të veprimtarisë, gjë që vërtetohet me lejimin përvendosjen e objektit.

Pas mbarimit të orarit të punës, pronari i objektit nga paragrafi I i këtij nenit, është i obliguar që ta largoj objektin dhe ta kthejë hapësirën në gjendjen e mëparshme.

#### **Neni 26**

Organi administrativ kompetent për punët komunale, mund të lejojë në ditë të veçanta ose në intervale kohore, zonat për këmbësor dhe lokacioneve në truallin në pronësi të Komunës së Tuzit, organizimin e prezantimeve të rastit, manifestimeve dhe shitjes së mallrave në objektet e përkohshme të tipit –shtand ose pulte eksposuese dhe ngjashëm, në pajtim me kushtet e paraparamë këtë Vendim dhe Plan.

#### **Neni 27**

Përshtatshmëria për përdorimin e objekteve të përkohshme nga nenit 5 pika 5 e këtij vendimi përcaktohet përmes kontrollit teknik.

Organi i cili e ka lëshuar lejen kontrollon kontrollin teknik nga paragrafi 1 i këtij nenit subjektit kompetent, i cili është i obliguar që raportin për kontrollin teknik t'ia paraqesë organit në afat prej shtatë ditësh prej ditësh prej përfundimit të kontrollit teknik.

Organi nga paragrafi 2 i këtij nenit, është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh prej ditës së dorëzimit të raportit për kontrollin teknik të objektit të sjellin aktvendim, në pajtim me rezultatin e raportit.

### **V DHËNJA ME QIRA E TRUALLIT NË PRONËSI TË KOMUNËS SË TUZIT**

#### **Neni 28**

Trualli në pronësi të shtetit ose komunës mund të jetet me qira në afat të caktuar, me qellim të vendosjes së objekteve nga nenit 5 paragrafi 1 pika 1,2,3,4 dhe 5 i këtij vendimi, në perputhje me Planin e objekteve të perkohëshme të Komunës së Tuzit.

#### **Neni 29**

Trualli nga nenit 28 i këtij Vendimi lëshohet me qira në bazë të rregullores së Ligjit mbi pasurinë shtetërore, Rregullores për shitjen dhe dhënien me qira të sendeve në pronësi shtetërore, të këtij Vendimi dhe Plani.

Në perjashtim të kësaj me qira mund të jepet edhe trualli i cili nuk është i paraparë me Plan, nëse në truallin e paraparë është i ndërtuar objekti i përkohshëm bazuar në rregulloret e mëparshme, në pajtim me aktin e organit administrativ kompetent.

Trualli nga paragrafi 1 i këtij nenit jepet me qira në periudhë deri në një vit, për vendosjen e objekteve të përkohshme nga nenit 5 pika 4 e këtij vendimi, me mundësi të vazhdimit të qirasë për vitin e ardhshëm, përderisa shfrytëzuesi rregullisht i ka kryer obligimet mbi këtë bazë për periudhën paraprake.

Trualli nga paragrafi 1 i këtij nenit, jepet me qira në periudhë deri në tri vjet, për vendosjen e objekteve të përkohshme nga nenit 5 pika 1,2,3,4, dhe 5 i këtij vendimi, me mundësi të vazhdimit të qirasë nëse shfrytëzuesi i ka kryer obligimet rregullisht mbi këtë bazë për periudhën e mëparshme.

Nëse gjatë afatit të marrëveshjes së qirasë vjen deri te ndryshimi i truallit të destinuar të paraparë me dokument planor, kontrata nuk do të përsëritet dhe qiramarrësi nuk ka të drejtë në kompensim të atyre që i ka investuar deri në atë kohë.

### **Neni 30**

Qiraja përcaktohet në bazë të vlerës së tregut të truallit në pronësi të shtetit ose komunës për  $1m^2$

Lartësia e shumës më të ulët në periudhën prej një viti është 15% e vlerës së tregut të truallit.

Qiraja për truallin sipas rregullit paguhet njëherësh, me rastin e lidhjes së Kontratës mbi qiramarrjen e truallit.

## **VI MBIKËQYRJA**

### **Neni 31**

Mbikëqyrjen administrative mbi realizimin e këtij Vendimi e bën organi kompetent për punët komunale.

Punët e inspektionit mbikëqyrës mbi realizimin e këtij vendimi i kryen inspektori Komunal.

Mbikëqyrja komunale dhe sigurimi i rendit në vendosjen dhe ndërtimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues të paraparë me këtë vendim dhe kontrollimin e zbatimit të këtij vendimi në pajtim me Ligjin mbi policinë Komunale, e kryen policia Komunale.

### **Neni 32**

Pasi të vërtetohet se objekti i përkohshëm është vendosur pa leje ose është kundër kushteve të caktuara nga leja, inspektori Komunal është i autorizuar të urdhërojë largimin e objektit të përkohshëm në afat jo më të gjatë se 15 ditë.

Pronari i objektit të përkohshëm është i obliguar ta mirëmbajë objektin e përkohshëm si dhe hapësirën përkatëse përreth në gjendje të rregullt teknike, estetike dhe funksionale.

Pronari i panosë reklamuese-shpallëse në fasadë ose çati të ndërtesës, mban përgjegjësi për sigurinë e atij objektit dhe i njëjtë e mirëmban në gjendje të rregullt teknike, estetike dhe funksionale.

Inspektori komunal është i obliguar ti urdhëroj pronarit të objektit që ti eliminoj të gjitha mangësitë në objekt të shkakuara gjatë shfrytëzimit të tij.

## **VII DISPOZITAT NDESHKUESE**

### **Neni 33**

Me gjobë prej në 150 euro deri në 5.000 euro do të ndëshkohen për shkelje personat fizik, nëse:

- vendos ose ndërton objekt të përkohshëm pa miratimin e organit të qeverisjes lokale kompetent

për punët komunale, gjegjësishët miratimit të organit të administratës lokale të Komunës urbane për objektet në trevën e saj (neni 17);

- nuk e largon objektin e përkohshëm në afat prej shtatë ditësh prej ditës së skadimit të vlefshmërisë së lejes, gjegjësishët prej ditës së marrjes së njoftimit mbi kthimin e truallit në destinimin e planifikuar të përcaktuar me dokumentacion planor (neni 23 paragrafi 1);

- vendos objekt të përkohshëm të tipit – automjet i veçantë i cili e ka atestin e prodhimit për kryerjen e veprimtarive në zonat I dhe II të truallit ndërtimor e përcaktuar me dispozita të veçanta të Komunës së Tuzit (neni 23);

- nuk e largon objektin e përkohshëm të tipit – shtand i cili është vendosur për prezantim dhe promociion të programeve të karakterit edukativ dhe argëtues, objekteve të artit, librave, CD-ve, shtypit dhe publikimeve të tjera, urimeve të veçanta luleve dhe prodhimeve shtëpiake pas mbarimit të orarit të punës dhe vendin e shfrytëzuar nuk e kthen në gjendjen e mëparshme ( neni 25 paragrafi 3);

- nuk e mirëmban objektin e përkohshëm në mënyrë teknike, estetike dhe funksionale në mënyrën e duhur (neni 25 paragrafi 2);

- nuk e mirëmban panon reklamuese-shpallëse të fasadës apo të çatisë në gjendjen e duhur teknike, estetike dhe funksionale (neni 32 paragrafi 3).

Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni do të ndëshkohen personat fizik dhe personat përgjegjës, në personin juridik dhe me gjobë prej 20 euro deri në 800 euro.

Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni do të ndëshkohet afaristi me gjobë prej 50 euro deri në 1500 euro.

## VIII DISPOZITAT PERFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

### Neni 34

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfrytëzuesi i lokacionit të përcaktuar me Elaborat valid ruan të drejtën e shfrytëzimit të të njëjtit, deri në skadimin e afatit të përcaktuar me aktvendim, gjegjësishët deri në sjelljen e Planit në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi.

### Neni 35

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë prej ditës së publikimit në “Fletën zyrtare të Malit të Zi-dispozitat komunale”.

Numër: 02-030/20-  
Tuz, \_\_\_\_\_.2020

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT  
KRYETARI,  
Fadil Kajoshaj**